



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR

ELBASAN

Nr. AKTI 1255
Datë Regj 02.12.2019

Nr.Vendimi 1255
Datë Vendimi 27.12.2019

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me trup gjykues të përbërë prej:

GJYQTARE: ENKELEDA KAPEDANI

Me sekretare gjyqësore **Vjollca Karapinjalli**, në 27.12.2019 shqyrtoi kërkesën penale që i përket:

KËRKUES: **Viktor Ymeri (Imeraj)**, i biri i Ymer dhe Xhahane, i dtl 26.07.1967 lindur dhe banues në Vlorë, me arsim 10 klase, i martuar, i dënuar më parë.

I interesuar: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, përfaqësuar në gjykim nga prokurori **Mustafa Turku**.

Me pjesmarrjen: **IEVP Peqin**, përfaqësuar në gjykim nga Hajrije Thartori me autorizim. (Në mungesë në shpallje)

OBJEKTI: Shuarje dënimit dhe lirim i menjëhershëm.

BAZA LIGJORE: Neni 480 të K.Pr.Penale.

Në përfundim të gjykimit zhvilluar në prani të kërkuarit Viktor Ymeri, të përfaqësuesit të Prokurorisë Mustafa Turku, Gjykata pasi shqyrtoi në tërësi rrethanat e çështjes dhe çmoi dhe vlerësoi në tërësi provat e marra në seancë gjyqësore nënshtruar rregullave të gjykimit dhe dëgjoi në fazën e konkluzioneve përfundimtare palët, të cilët kërkuan:

I dënuari: Pranimin e kërkesës.

Prokurori: Rrëzimin e kërkesës.

IEVP Peqin: Në mungesë në shpallje.

Si dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN SE:

I. Procedura dhe rrethanat e faktit

1. Para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është paraqitur kërkesa penale, me objekt dhe bazë ligjore të cituar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

2. Fillimisht gjykata mori në shqyrtim juridiksionin dhe kompetencën për gjykimin e kësaj çështje penale. Bazuar në nenet 512 e vijues të K.Pr.Penale shqyrtimi i kësaj çështje penale, hyn në juridiksionin gjyqësor dhe kompetente nga pikëpamja lëndore dhe tokësore për

shqyrtimin e saj është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Gjykimi i kësaj çështje penale u zhvillua me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar, siç përcaktohet edhe në nenin 13 të K.Pr.Penale.

3. Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi e provuar se, i dënuari Viktor Ymeri është arrestuar në dt 29.06.1999 për veprën penale të “Vrasjes me dashje” e kryer në bashkëpunim me paramendim dhe “Armëmbajtje pa leje” sipas neneve 78 dhe 25 dhe 278 të K.Penal dhe është dënuar me vendimin nr.175 dt 20.04.2000 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me burgim të përjetshëm. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.58 dt 15.03.2001. Ky vendim është rekursuar në Gjykatën e Lartë e cila me vendimin nr.505, dt 15.03.2001 ka vendosur “Mospranimin e rekursit”. Më tej i dënuari Viktor Ymeri ka bërë kërkesë për rishimin e vendimit në Gjykatën e Lartë e cila me vendimin nr.179 dt 28.10.2015 ka vendosur “Prishjen e vendimeve nr.505 të Gjykatës së Lartë, nr.58 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe vendimin nr.175 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës por me tjetër trup gjykues”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr.450 dt 23.06.2017 ka vendos të deklarojë fajtor shtetasin Vitkor Ymeri dhe e ka dënuar me burgim të përjetshëm. Ky vendim është ankimuar nga i dënuari dhe **Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.1993 dt 14.11.2018 ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr.450 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për të dënuarin Viktor Ymeri dhe dënimin e tij me 25 vjet burgim.**

4. Gjithashtu ky shtetas është dënuar nga Gjykata e Romës Itali për veprën penale të “Vrasjes me dashje” në bashkëpunim mbetur në tentative sipas neneve 79/dh dhe 25-22 të K.Penal për një ngjarje të ndodhur në vitin 1996 në Itali, pra para asaj që është duke vuajtur dhe është dënuar me 24 vjet burgim. Ky vendim është njohur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr.1178 dt 21.12.2016 duke i caktuar dënim me 23 vjet burgim pasi 1 vit është konsideruar i ulur me aministrinë e ligjit nr.22/2014. **Ndërsa Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.606 dt 14.04.2017 ka vendosur të lërë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe ti caktojë dënim me 24 vjet burgim.**

5. Me kërkesë të të dënuarit atij i është caktuar një dënim i vetëm me 25 vjet burgim me vendimin nr.444 dt 31.05.2019 i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.368 dt 30.10.2019. Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur të lërë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me plotësimin që **i dënuari Viktor Ymeri duhet të vuajë edhe 3 muaj e 20 ditë burgim nga dita e shpalljes së vendimit të apelit, pasi nuk i ka njohur atij ditët e punës të kryera në IEVP për shkak të mungesës së dokumentacionit në dosje.**

6. Në këto kushte i dënuari i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt “**Njohje e ditëve të punës**” të kryera në burg dhe ti konvertohen në ulje dënimi siç edhe i ishin konvertuar disa kohë më pare nga IEVP Peqin, fakt ky i pranuar nga ana e përfaqësuesve të IEVP Peqin në seancë. Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr.1212 dt 27.11.2019 ka vendosur “**Pranimin e kërkesës. Njohjen e ditëve të punës të kryera nga i dënuari Viktor Ymeri, konvertuar në 5 muaj e 16 ditë burgim. Një kopje e këtij vendimi ti dërgohet për ekzekutim Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan.....**”. Nga vendimi i mësipërm dhe nga procesverbali i seancës gjyqësore rezulton se prokurori i seancës ka qenë dakord me këtë kërkesë të të dënuarit pasi atij i takonin ditët e punës, por pavarësisht kësaj për shkaqe të paqarta ai ka paraqitur ankim kundër këtij vendimi duke refuzuar që të bëj ekzekutimin e vendimit, në kundërshtim me atë që kishte urdhëruar vendimi gjyqësor.

7. Për shkak të mosekzekutimit të këtij vendimi gjyqësor i dënuari ka paraqitur një kërkesë të re me objekt **“Shuarje dënimi dhe lirim i menjëhershëm”**. I dënuari kërkoi që të urdhërohej lirimi i tij pasi e kishte plotësuar dënimin e dhënë që në dt 04.09.2019, ndërsa prokurori kërkoi rrëzimin e kërkesës deri sa të shprehej Gjykata e Apelit Durrës për vendimin që ai kishte ankimuar lidhur me njohjen e ditëve të punës.

II. Ligji i zbatueshëm

- Neni 462 i K.Pr.Penale i cili parashikon se: *“2. Vendimi i pafajësisë, i përjashtimit të të gjykuarit nga dënimi dhe ai i pushimit të çështjes, vihet në ekzekutim menjëherë pas shpalljes.”*
- Neni 480 i K.Pr.Penale i cili parashikon se: *“1. Në fazën e ekzekutimit, gjykata është kompetente të vendosë për shuarjen e veprës penale pas dënimit, për shuarjen e dënimit, për dënimet plotësuese, për konfiskimin ose kthimin e sendeve të sekuestruara, si dhe për çdo rast të parashikuar me ligj. 2. Kur vërtetohet shuarja e veprës penale ose të dënimit, gjykata e deklaron këtë edhe kryesisht, duke marrë masat përkatëse.”*
- Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr.2/2014.
- Cështja Gjyli kundër Shqipërisë.
- Ligji Nr.8331, datë 21.4.1998 *“Për ekzekutimin e vendimeve penale”*.
- Dekreti nr.7298 dt 08.04.1989.

III. Vlerësimi i gjykatës

8. Me ekzekutim të vendimit penal sipas nenit 2 të Ligjit nr.8331/1998 kuptohet: *“Zbatimi i urdhërimeve që përmban vendimi penal i formës së prerë dhe i vendimeve që sipas K.Pr.Penale kanë ekzekutim të menjëhershëm, me synimin e riedukimit të të dënuarve të rivendosjes së të drejtave të personave të procedur padrejtësisht dhe të drejtave të subjekteve juridik të cënuara nga vepra penale, duke ndikuar në parandalimin e tyre.”* Pra qëllimi i ekzekutimit të vendimit penal përkon me vetë qëllimin e dënimit penal atë të riedukimit dhe të parandalimit të autorit të veprës penale dhe po ashtu nëpërmjet ekzekutimit të vendimeve rivendosen në vend të drejtat e personave që janë cënuar nga vepra penale ose e personave të proceduar padrejtësisht për vepra penale. Vendimet ndahen në dy kategori kryesore: 1) vendime që ekzekutohen pasi marrin formë të prerë dhe 2) vendime që ekzekutohen menjëherë.

9. Vendime që nuk kanë marrë formë të prerë ose vendime me ekzekutim të menjëhershëm janë vendime të cilat ekzekutohen menjëherë me shpalljen e tyre pavarësisht shkallës së gjykimit. Këtu përfshihen vendimet e pafajësisë, të pushimit të gjykimit, **vendimet e përjashtimit nga dënimi**, të shuarjes së dënimit, të heqjes së masës personale shtrenguese kur masa e dënimit është më e vogël se sa masa e paraburgimit të vuajtur, kur i dënuari lirohet me kusht, pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në prove, qëndrimi në shtëpi etj..... Pra vendime me ekzekutim të menjëhershëm janë ato vendime që lidhen drejtpërdrejtë dhe kanë ndikim në lirinë personale të qytetarëve. Në arritjen e këtij konkluzioni mbahet parasysh edhe arsyetimi i bërë nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues Nr.2/2014, ku sqarohen konceptet e formës së prerë, gjësë së gjykuar etj.

Në këtë vendim ndër të tjera arsyetohet se Raporti Shpjegues i Konventës Evropiane për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Vendimeve Penale (Raporti Shpjegues)¹ shpjegon se: *Në anën tjetër, një vendim i ekzekutueshëm nuk është domosdoshmërisht final meqenëse apeli mund të mos rezultojë në pezullimin e tij. Prandaj, ekzekutueshmëria nuk mund të identifikohet plotësisht me të qenit final dhe për këtë arsye u konsiderua e domosdoshme që të përcaktohej karakteri i ekzekutueshëm i një vendimi si një kusht tjetër i ndarë nga të tjerët*". Gjithashtu, ligji Nr.8331/1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", në nenin 21 parashikon se: *Ekzekutohen me urdhër të gjykatës menjëherë pas shpalljes së vendimit: 1) Vendimet penale që përmbajnë pafajësi, përjashtimin e të gjykuarit nga dënimi ose pushimin e gjykimit të çështjes sipas pikës 2 të nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe kur gjendet i paligjshëm arresti në flagrancë ose ndalimi, duke urdhëruar lirinë e menjëhershëm, përveç kur ka një masë sigurim me arrest për shkak tjetër, si dhe pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë. Po kështu neni 260 i K.Pr.Penale parashikon rastet kur personi nuk mund ta mbahet në burgim në rast se ekziston një vendim gjyqësor që lidhet me lirinë personale, si vendim menjëherë i ekzekutueshëm pa pritur që vendimi të marrë formë të prerë.*

10. Në rastin konkret të dënuarit Viktor Ymeri i janë njohur ditët e punës të konvertuara në 5 muaj e 16 ditë si periudhë që duhet ti ulet atij në periudhën e vuajtjes së dënimit. Duke qenë se ky vendim është ankimuar, atëherë prokurori nuk bën ekzekutimin e tij dhe nuk lejon lirinë e të dënuarit. Në këto kushte kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për shuarjen e dënimit pasi nga përlogaritjet rezulton se ai ka vuajtur periudhën e dënimit të dhënë.

11. Në këtë rast, Gjykata çmon se ndodhet para shuarjes së dënimit, duke qenë se dënimi i dhënë është vuajtur duke llogaritur edhe periudhën e ditëve të punës të njohura më parë me një vendim gjyqësor. Në lidhje me pretendimin e organit të akuzës se ky vendim nuk mund të ekzekutohet pasi nuk ka marrë formë të prerë nuk qëndron për disa arsye:

12. Vendimi që konverton ditët e punës në ditë burgu duke u njohur si periudhë dënimi të vuajtur është vendim që duhet të ekzekutohet menjëherë pa marrë formë të prerë. Ky është një vendim që lidhet drejtpërdrejtë me lirinë e personit e si i tillë është menjëherë i ekzekutueshëm. Karakteri menjëherë i ekzekutueshëm i një vendimi gjyqësor bazohet edhe në nenin 11 të Ligjit Nr.8331, datë 21.4.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale" i cili parashikon se: *"Për vendimet penale me ekzekutim të menjëhershëm urdhërimet i jep gjykata që ka dhënë vendimin menjëherë pas shpalljes së tij"*. Në rastin konkret jo më kot gjyqtari në vendimin nr.1212 dt 27.11.2019 është shprehur në mënyrë eksplicite si vijon *"....Një kopje e këtij vendimi ti dërgohet për ekzekutim Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan...."*. Ky urdhërim është dhënë për shkak të natyrës menjëherë të ekzekutueshme të këtij vendimi gjyqësor. Por në rastin konkret ka ndodhur që prokurori refuzon të bëjë ekzekutimin me argumentin që vendimi është ankimuar. Siç edhe kam argumentuar më sipër vendimet ndahen në dy kategori kryesore: 1) vendime që ekzekutohen kur vendimi merr formë të prerë; 2) vendime që ekzekutohen menjëherë pas shpalljes së tyre. **Në rastin konkret vendimi gjyqësor që i ka njohur të dënuarit ditët e punës duke u konvertuar në burg e si rrjedhim në ulje dënimi**

¹ Raport Shpjegues i Konventës Evropiane për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjykimeve Penale, CETS No. 70, bërë në Hagë me datë 28.05.1970, ratifikuar me Ligjin nr.9068, datë 15.05.2003, "Për ratifikimin e "Konventës Evropiane për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjykimeve Penale". Cituar gjithashtu nga Raporti Shpjegues i Protokollit nr.7 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996 "Për Ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore".

është vendim që lidhet drejtpërdrejtë me lirinë personale dhe është menjëherë i ekzekutueshëm. Nga kjo rrjedh se i dënuari Viktor Ymeri e ka plotësuar vuajtjen e plotë të dënimit në dt 04.09.2019.

13. Duke qenë se për këtë të dënuar pritej një vendim nga Gjykata e Apelit Durrës për tu shprehur në lidhje me bashkimin e dënimeve, nuk u bë i mundur lirimi i tij në dt 04.09.2019 nga ana e IEVP edhe pse kjo e fundit ja njihte ditët e punës. Nga aktet e administruara në dosje rezulton se Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.386 dt 30.10.2019 ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan me plotësimin që ai duhet të vuaj edhe 3 muaj e 20 ditë burgim pasi nuk i ka konsideruar të mirëqenë periudhën e uljes së dënimit të përfituar me punë nga ana e të dënuarit, duke dal jashtë objektit të gjykimit. **Objekt gjykimi në Gjykatën e Apelit Durrës ishte bashkimi i dënimeve për të dënuarin Viktor Ymeri, ndërsa llogaritja e ditëve të mbetura është detyrë e IEVP dhe jo e gjykatës kryesisht, pa patur më parë një kërkesë nga i dënuari.** Nga sa më sipër rezulton se Viktor Ymeri duhet të ishte liruar që në dt 30.10.2019 kur Gjykata e Apelit Durrës la në fuqi vendimin që e dënonte përfundimisht me 25 vjet burgim, mqns sipas përlllogaritjeve përfshirë edhe ditët e punës ai e kishte plotësuar dënimin që në dt 04.09.2019. **Por ky “gabim” i Gjykatës së Apelit Durrës me apo pa dashje, i hapi rrugë kërkesave të reja të tij në gjykatë siç ishte ajo e “Njohjes së ditëve të punës” dhe më pas ajo e “Shuarjes së dënimit”.**

13.1 Gjykata e Apelit Durrës nuk ja njohu ditët e punës pasi në dosje nuk kishte prova që provonin këtë fakt, përveç dinamikës së paraqitur nga IEVP e cila provonte faktin që ai kishte përfituar pikërisht 5 muaj e 16 ditë ulje dënimi si pasojë e punësimit në IEVP. Vendimi i gjykatës së apelit lidhur me kërkesat e palëve në fazën e ekzekutimit është vendim i formës së prerë në kuptimin formal dhe jo substancial të tij, pra i dënuari në çdo kohë mund të kërkojë ti njihet e drejta e tij mjaft që ai të paraqes provat e nevojshme siç edhe ka ndodhur në rastin konkret. Pra i dënuari ka paraqitur provat para gjykatës dhe kjo e fundit ja ka njohur këtë periudhë si periudhë pune duke u reflektuar në 5 muaj e 16 ditë ulje dënimi nga dënimi i mbetur. Në këto kushte vendimi nr.1212 dt 27.11.2019 duhet të ishte ekzekutuar menjëherë nga prokurori dhe fakti që ai nuk e ka bërë tregon se jemi para rastit kur ai ka refuzuar të ekzekutoj një vendim gjyqësor menjëherë të ekzekutueshëm. Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Gjyli kundër Shqipërisë citon se *“Përsa i përket rastit në fjalë, Gjykata vëren se informacioni i paraqitur nga pala shqiptare në lidhje me dosjen e burgut të ankuesit, tregon se ka të dhëna për vetëm dy muaj nga tre vitet e dënimit që ai vuajti në burgun e Batërit. Gjykata vëren se përgjegjësia për mbajtjen e të dhënave të duhura i takon administratës së burgut. Të dënuarit nuk duhet të cenohen nga pamundësia e tyre në mbajtjen e të dhënave të tilla, dhe për pasojë periudha e ndalimit të tyre nuk duhet të zgjatet.* Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se kur përballet me një konflikt që ka të bëjë me rrethanat e sakta të çështjes, një shtet anëtar nuk mund të pretendojë të përmbushë detyrimet e tij sipas Konventës, nëse nuk paraqet të dhëna të plota të dosjeve të burgut. Në mungesë të dokumentacionit ose fakteve kundërshtuese, Gjykata mund të marrë për bazë deklaratimet e ankuesit (shih mutandis mutandis Messina v. Italy, vendimi i 26 shkurtit 1993, Seria A, nr. 257-H, § 31)....”. Pra, është detyrë e të gjitha institucioneve të vendit tonë duke filluar nga IEVP Peqin, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Gjykata e Apelit Durrës, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, e në fund detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan që të llogarisë drejtë dhe saktë të gjitha ditët vuajtura në burg nga ana e të dënuarit. **Asnjë prej institucioneve të mësipërme nuk mund të bëj vlerësime personale dhe subjektive, nëse të dënuarit i takon një periudhë dënimi e vuajtur apo jo, këtë mund ta vendos ligji dhe vetëm ligji.** IEVP Peqin sjell provat që provojnë se i dënuari Viktor Ymeri ka punuar në IEVP, ndërsa Dekreti

nr.7289, datë 08.04.1989 "Për zbritjen e dënimit të personave të dënuar me heqje lirie, që aktivizohen në punë, kur plotësojnë e tejkalojnë normën" përcakton se ditët e punës të kryera në IEVP konvertohen në 3,9 ditë ulje dënimi në muaj, madje ky fakt promovohet edhe në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në linkun vijues:

<http://dpbsh.gov.al/newweb/?fq=brenda&gj=gil&kid=45>

14. Edhe sipas një monitorimi të kryer nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit i cili informon Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhur me problematikën e hasur gjatë trajtimit të kërkesave/ankesave të të burgosurve apo nga monitorimet e kryera prej tyre në burgje rezulton se: "... IEVP-të nuk zbatojnë të njëjtën praktikë sa i takon njohjes së punës së të dënuarve dhe përfitimit të shpërblimit lidhur me të. **KSHH konstaton se është ende në zbatim ligji i vjetër sa i takon mënyrës së shpërblimit të punës së të dënuarve, dmth 3.9 ditë në muaj i zbritet dënimit të tyre.** Progres Raporti i vitit 2015 për Shqipërinë shprehet se dhe **ata pak të burgosur që punojnë marrin ulje të dënimit dhe jo shpërblim.** Ligji parashikon se puna shpërblehet dhe pagesa jepet si shpërblim në raport me punën e kryer, konform rregullave që përcaktohen në VKM përkatëse....(ndër të tjera në këtë vendim citohet- shënimi im)... **Me shkresën nr.8380/1 prot., datë 27.09.2017 Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve informon Komisionerin se: "Dekreti nr.7289/1989 "Për zbritjen e dënimit të personave të dënuar me heqje lirie, që aktivizohen në punë, kur plotësojnë e tejkalojnë normën", i Presidiumit të Kuvendit Popullor, ka mbetur në fuqi dhe nuk është shfuqizuar me asnjë akt ligjor dhe nënligjor.** (Shiko vendimin Nr.100, Datë 05.04.2018 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi)

15. Në rastin konkret IEVP Peqin sjell prova që vërtetojnë se Viktor Ymeri ka punuar në këtë IEVP, por është e paqartë pse këto institucione refuzojnë tja njohin ditët e punës e si rrjedhim edhe uljen në raport me ditët e punës të kryera prej tij, përse kohë ai nuk ka përfituar shpërblim monetar. Ky i dënuar mbahet në IEVP edhe pse sipas dokumentacionit të ndodhur në dosjen e tij duhet të ishte liru kohë më parë, pa u kuptuar arsyeja dhe qëllimi, në një kohë që praktika që ndiqet për çdo të dënuar tjetër është që i njihen ditët e burgut nga vet IEVP kryesisht, duke ja konvertuar në 3,9 ditë ulje dënimi në muaj. Madje është vet IEVP e cila kryesisht liron të dënuarit sa herë që gjykata vendos ulje dënimi të periudhës së mbetur të dënimit. Ky institucion nuk pret që vendimi i uljes të marrë formë të prerë, por e ekzekuton atë menjëherë duke qenë se jemi para një vendimi që lidhet me lirinë personale. Duket se IEVP është njohesë më e mirë e ligjit se sa organi prokurorisë të cilët presin që vendimi i lirisë të marrë formë të prerë e më pas ta ekzekutojnë atë!!!!

15.1 Nga studimet e praktikave të gjithsej në 23 IEVP në RSH përfshi edhe studimet e kryera nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit apo Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rezulton se te gjithë të dënuarit e punësuar përfitojnë ulje dënimi në masën 3,9 ditë në muaj dhe nuk përfitojnë shpërblim monetar. (Shiko vendimin Nr.100, Datë 05.04.2018 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi). Megjithatë në çështjen objekt gjykimi rezulton se përbën përjashtim dhe praktika merr rrjedh tjetër sepse i dënuari quhet "Viktor Ymeri" i cili ka bërë vrasje të dyfishtë. Një nga parimet bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është sanksionuar në nenin 18 të saj si vijon: "**Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit**". Ky është një nga parimet bazë që udhëheq veprimtarinë e gjykatës dhe specifikisht të gjyqtarës së kësaj çështje, e cila nuk bën asnjë dallim midis askujt dhe i trajton të gjithë qytetarët e Republikës së Shqipërisë në mënyrë të barabartë. Nuk mundet gjykata në fazën e ekzekutimit të vlerësojë rrezikshmërinë e autorit apo të veprës penale të kryer prej tij, këto element

vlerësohen nga gjykata që ka caktuar dënimin e tij në themel. Kërkesat në fazën e ekzekutimit janë kërkesa të cilat bazohen në ligje të ndryshme që i japin mundësi të dënuarit të përfitojë ulje dënimi gjatë vuajtjes së saj si psh: lirim para kohe me kusht, përfitim nga amnistia, ulje dënimi etj. Për gjykatën në këtë fazë nuk përbën dallim se kush është i dënuari, çfarë vepr penale ka konsumuar ai, çfarë rrezikshmërie shoqërore ka ai, sepse ligji është një dhe i barabartë për të gjithë. Nëse kërkesa e tij është e bazuar në ligj dhe në prova, sigurisht që kërkesa do të pranohet pa asnjë dyshim, në të kundërt kërkesa do të rrëzohet pa hezitim. Në këtë fazë të procedurës së këtij të dënuari gjykata nuk ka në diskrecion të saj të vlerësojë elementët e sipërcituar, në këtë fazë gjykata bën një vlerësim mekanik të situatës duke vënë në zbatim parimet bazë të së drejtës. Në këtë rast gjykata *prima facia* verifikon periudhën e vuajtur dhe të mbetur të dënimit. Nga aktet rezultoi se të dënuarit i ka mbetur për të vuajtur edhe 1 muaj e 23 ditë në ditën e shqyrtimit të kësaj kërkesë, si dhe faktin që ai ka përfituar ulje dënimi për shkak të punësimit në IEVP me vendimin nr.1212 dt 27.11.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan e barabartë me 5 muaj e 16 ditë, duke bërë që dënimi i tij konsiderohet i vuajtur që në dt 04.09.2019. Gjykata vlerëson se kjo masë dënimi e ulur duhet të pasqyrohet menjëherë në dinamikën e vuajtjes së dënimit të të dënuarit, për shkak të natyrës së këtij vendimi si menjëherë i ekzekututeshëm, e më pas llogaritet periudha e mbetur e dënimit, e cila në rastin konkret rezultoi se ishte shlyer tërësisht. **Sa më sipër, janë IEVP Peqin, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan institucionet përgjegjëse të cilat duhet të përgjigjen para ligjit se përse për këtë të dënuar nuk është ndjekur praktika si për çdo të dënuar tjetër, duke i trajtuar rastet në mënyrë thelbësisht të diferencuar, përse ky i dënuar është mbajtur në burgim pa vendim.**

(Kjo pasi ndaj tij kishte një vendim që i ulte dënimin me 5 muaj e 16 ditë). Rëndësia që ka liria e personit në shoqërinë tonë demokratike pasqyrohet edhe në dispozitat e Kodit Penal ku ligjvënësi i ka dhënë një mbrojtje të posaçme në nenin 252 i cili parashikon se "Mbajtja në burg pa vendim të organit kompetent ose tej afatit të caktuar në vendim apo në ligj, prej personit të ngarkuar me detyrën e administratorit të burgut, përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet". Trajtimi që i është bërë rastit konkret organeve përgjegjëse duke e mbajtur atë në burgim pa vendim gjyqësor mund të konsiderohet se kanë shkuar deri në kufijtë e veprës penale.

16. Pavarësisht sa më sipër, Gjykata vlerëson se njohja e ditëve të punës në çdo rast bëhet nga vet IEVP pa qenë nevoja për vendim gjyqësor, kjo pasi vendimi gjyqësor nuk përcakton faktin nëse i dënuari ka qenë apo jo i punësuar në IEVP. Këtë fakt e përcakton praktika e tij e punësimit e mbajtur nga IEVP përkatëse. Në një rast të tillë, nëse IEVP do refuzonte njohjen e ditëve të punës dhe i dënuari i drejtohet gjykatës, siç edhe ka ndodhur në rastin konkret, atëherë vendimi gjyqësor nuk do ishte vendim krijues i së drejtës së të dënuarit, por do ishte vendim konfirmues pasi gjyqtari vetëm do konstatonte faktin që ai ka punuar bazuar në provat e paraqitura nga IEVP dhe konvertimi i ditëve të punës në ulje dënimi është pasojë *ipso lege* e dekretit nr.7298 dt 08.04.1989. Pra, Gjykata thjesht konstaton faktin e punësimit në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga IEVP dhe bazuar në dekretin e vitit 1989 e konverton atë në ulje prej 3,9 ditë në muaj. **Nga kjo rrjedh se në rastin konkret nuk ka vend për diskutim nëse i dënuari e përfiton këtë ulje apo jo, pasi provat e IEVP provojnë faktin që ai ka punuar (prova të cilat nuk ishin në dojse kur Gjykata e Apelit Durrës nuk i ka njohur ato) dhe është vet legjislacioni përkatës i cili automatikisht ja konverton këtë periudhë në ulje dënimi. Pra në një rast të tillë gjykata vetëm konstaton faktin që i dënuari ka punuar dhe ulja e dënimit si pasojë e periudhës së punësimit vjen**

për shkak të legjislacionit në fuqi në vendin tone dhe jo për shkak të vlerësimit subjektiv të gjyqtarit.

17. Edhe në çështjen objekt gjykimi përfaqësuesja e IEVP ka pranuar në seancë faktin që i dënuari Viktor Ymeri ka qenë i punësuar në organikën e punësimit në institucion në periudha të ndryshme, dhe se ata ja kanë njohur këtë periudhë si ulje dënimi në dinamikat e mëparshme, por nuk ja njohin më pasi ka një vendim të gjykatës së apelit që nuk ja quan ditët e punës, si dhe fakti që prokurori nuk nxjer urdhrin e ekzekutimit edhe pse ka një vendim tjetër gjyqësor që ja ka njohur këtë periudhë si ulje dënimi.

18. Fakti që vendimi i njohjes së ditëve të punës është menjëherë i ekzekutueshëm dhe se nuk duhet të pritet që ai të marrë formë të prerë mbështet edhe në faktin që nëse i dënuari do kishte kërkuar në rastin e parë njohje të ditëve të punës dhe shuarjen e dënimit njëkohësisht, atëherë gjykata do dispononte duke pranuar të dyja kërkesat, pasi nëse ajo do pranonte të njëjtit ditët e punës (të cilat siç edhe e përmendëm më sipër vetëm i konstaton formalisht) atëherë pasoja që do vinte si pasojë e njohjes së ditëve të punës do ishte shuarja e dënimit. Është alogjike të mendosh që gjykata do pranonte të njëjtit ditët e punës dhe të mos e shuante dënimin, por ta pezullonte atë me argumentin që pjesa e parë e vendimit që njeh ditët e punës të marrë formë të prerë e më pas të shuhet dënimi.

19. Madje gjykata vlerëson se edhe nëse nuk do kishte fare vendim gjyqësor që njeh ditët e punës së të dënuarit, ky i fundit mund ti drejtohej gjykatës me kërkesë për shuarjen e dënimit për shkak të plotësimit të periudhës së dënimit të vuajtur si pasojë e ditëve të punës. Në një rast të tillë, gjykata do konstatoj faktin që ai ka punuar bazuar në provat e IEVP dhe do shuaj dënimin. **Pra ditët e punës mund të konvertohen në ulje edhe pa qenë objekt shqyrtimi gjyqësor, por vetëm duke u konstatuar ky fakt në gjykimin e shuarjes së dënimit. Si rrjedhim, gjykata vlerëson se nuk ekziston nevoja që të ketë një vendim gjyqësor që të njoh ditët e punës, e aq më pak të pritet që ky vendim të marrë formë të prerë, pasi fakti i punësimit mund të konstatohet në fakt edhe nga gjykata që po shqyrton shuarjen e dënimit. Kjo tregon se jo vetëm që nuk është e nevojshme që të pritet që vendimi i cili njeh ditët e punës të marrë formë të prerë (shiko vendimin unifikues Nr.2/2014 të Gjykatës së Lartë), por as nuk është nevoja për ekzistencën e një vendimi të tillë të mëvetësishëm, pasi një fakt i tillë konstatohet edhe gjatë gjykimin të shuarjes së dënimit sipas pretendimeve të kërkuarit dhe provave të dosjes.**

20. Pretendimi i prokurorisë se duhet të pritet që të shprehet gjykata e apelit nuk qëndron edhe për faktin se nëse do të pritej vendimi i kësaj gjykate çështja do të mbetej pa objekt. Bazuar në dinamikën e sjellë nga IEVP Peqin të dënuarit i ka mbetur për të vuajtur edhe 2 muaj e 2 ditë deri në dt 18.12.2019, **pra në ditën e shqyrtimit të kësaj kërkesë dt 27.12.2019 atij i ka mbetur për të vuajtur edhe 1 muaj e 23 ditë në total.** Nëse do pritet që të shprehet gjykata e apelit e cila nisur nga shpejtësia e shqyrtimit të kërkesave me shumë gjasa do të shprehet përtej afatit prej 1 muaj e 23 ditë, atëherë çështja do të mbetej pa objekt pasi ai do ishte liruar si pasojë e vuajtjes së dënimit në fakt. **Në këtë mënyrë do të cënoheni 6 i KEDNJ që është e drejta për një proces të rregullt gjyqësor duke mos i dhënë mundësi kërkuarit të ketë një vendim gjyqësor efektiv dhe të zbatueshëm për kërkesën e tij.**

21. Fakti që ky vendim është menjëherë i ekzekutueshëm dhe nuk është ekzekutuar nga prokurori tregon se ai nuk ka përmbushur në mënyrë të rregullt detyrën e tij duke refuzuar të ekzekutoj një vendim menjëherë të ekzekutueshëm, duke shkuar në kufijtë e veprës

penale të shpërdorimit të detyrës sipas nenit 248 të K.Penal. **Pra, gjykata vlerëson se organi procedues nuk ka identifikuar drejtë natyrën e vendimit gjyqësor si menjëherë të ekzekutueshëm dhe nuk e ka ekzekutuar atë me argumentin e ankimit në një gjykatë me të lartë, duke cënuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, ku e drejta për lirinë personale është e drejta me sensitive e cila mund të kufizohet vetëm me vendim gjyqësor.** Të gjitha vendimet gjyqësore që lidhen me liritë personale të një personi janë vendime menjëherë të ekzekutueshme për shkak të karakterit sensitiv që ka kjo e drejte dhe ky është parimi bazë i së drejtës. Në rastin konkret ka një vendim gjyqësor i cili ka njohur 5 muaj e 16 ditë si ditë punë, të cilat sipas dekretit të vitit 1989 dhe pjesës arsyetuese të vendimit gjyqësor nr.1212 dt 27.11.2019 konvertohen në 5 muaj e 16 ditë burgim, pra në 5 muaj e 16 ditë ulje dënimi. Për sa kohë të gjitha **organet përgjegjëse si IEVP Peqin, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan janë në dijeni të faktit që të dënuarit Viktor Ymeri i janë njohur 5 muaj e 16 ditë punë, aq më tepër janë të ndërgjegjshëm që kjo periudhë konvertohet në 5 muaj e 16 ditë ulje dënimi** (siç edhe përcakton Dekreti i vitit 1989, faqa zyrtare e Dr.P.Burgjeve, si dhe vendimi gjyqësor nr.1212/2019 Gj.Elbasan), **e si e tillë janë (minimalisht duhet të jenë) të ndërgjegjshëm që ky vendim është menjëherë i ekzekutueshëm pikërisht për faktin që jemi para uljes së dënimit e cila lidhet drejtpërdrejtë me liritë personale të të dënuarit.**

22. Pra Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr.1212, dt 27.11.2019 ka njohur ditët e punës dhe ka ulur masën e dënimit me 5 muaj e 16 ditë për të dënuarin Viktor Ymeri, vendim i cili duhet të ishte ekzekutuar menjëherë dhe të llogaritej në dinamikën e vuajtjes së dënimit të tij. **Në rastin konkret ky vendim është refuzuar të ekzekutohet nga ana e organit të akuzës duke shkuar në kufijtë e veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës" parashikuar nga neni 248 i K.Penal.**

22.1 Nga teoria e së drejtës penale dhe praktika gjyqësore rezulton se, element të anës objektive të figurës së veprës penale të cilat duke iu referuar interpretimit literal të dispozitës dhe praktikës gjyqësore për nenin 248 të K.Penal janë: **a) kryerja ose moskryerja e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin; b) veprimet ose mosveprimet perbejne mospermbushje të rregullt të detyrës; c) veprimet ose mosveprimet kryhen nga një person që ushtron funksione publike; d) veprimet ose mosveprimet i kanë sjelle personit ose personave të tjere përfitime materiale ose jomateriale ose kanë demtuar interesat e ligjshme të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjere juridike.** Pra, nga ana objektive kjo veper kryhet me veprime ose mosveprime, të cilat synojnë të pengojnë zbatimin e ligjit, por kjo karakterizohet nga fakti se, *se pari* -veprimi a mosveprimi duhet të kryhet nga personi në saj të detyrës dhe *se dyti* -që ai (veprimi ose mosveprimi) të vijë në kundërshtim me ligjin dhe kanë lidhje me detyrën, me të drejtat dhe kompetencat e dhena. **Veprimi a mosveprimi kryhen duke qene personi në krye të detyrës, apo duke shfrytëzuar vendin (postin) që ai mban dhe jep urdhera ose kryhen veprime të paligjshme, të cilat i sjellin pasoja interesave të shtetasve ose atyre shtetërore.** Në rastin konkret të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të të burgosurve, nuk kanë përmbushur në mënyrë të rregullt detyrat e tyre, ato kanë shfrytëzuar postin dhe kanë kryer veprime të paligjshme, duke demtuar të drejtat e ligjshme të një të dënuari me burgim, duke shkuar në kufijtë e veprës penale të shpërdorimit të detyrës.

23. Nga gjithë sa më sipër, pas njohjes së 5 muaj e 16 ditë ulje dënimi si pasojë e punësimit në IEVP Peqin, gjykata vlerëson se i dënuari Viktor Ymeri duhet të ishte liruar në dt 04.09.2019 kur është plotësuar dënimi i dhënë ose minimalisht në dt 27.11.2019 kur atij i janë njohur këto ditë pune (ulje) me vendim gjyqësor.

24. Për këto arsye, Gjykata pasi ka marrë në analizë të gjitha faktet e mësipërme vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi Viktor Ymeri është e bazuar në ligj dhe në prova, dhe si e tillë duhet të pranohet **duke i shuar dënimin e mbetur prej 1 muaj e 23 ditë.**

**PËR KËTO ARSYE,
Gjykata bazuar në nenet 379 dhe 480 të Kodit të Procedurës Penale,
VENDOSI:**

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shuarjen e dënimit dhënë me vendimin nr.444, datë 31.05.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.368, datë 30.10.2019, për të dënuarin Viktor Ymeri (Imeraj).
3. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të dënuarit Viktor Ymeri (Imeraj) nëse nuk mbahet i ndaluar, i arrestuar apo i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale.
4. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të kërkuesit.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Durrës brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmeja e shpalljes së këtij vendimi.
- **U shpall në Elbasan, sot me datë 27.12.2019.**

**SEKRETARE
VJOLLCA KARAPINJALLI**

**GJYQTARE
ENKELEDA KAPEDANI**